



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR			
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA			
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING			
Njësia Org. Org.Jedinica Org Unit	01/04	Nr.Prot. Broj.Prot. Prot.No	23-2/26
Nr. i faqeve Broj.stranica No.pages	-09-	Data Datum Date	16.06.2026
PRISHTINË/A			

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara /Office of the General Secretary

DATË/A:	09.06.2024
REFERENC-Ë:	23/26/MMPH
PËR/ZA/TO:	"Kelkos Energy" SH.P.K., Deçan, për HC Belaja
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, U.D. Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për vazhdim të Lejes Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), ka shqyrtuar kërkesën për vazhdim të Lejes Mjedisore të operatorit "Kelkos Energy" SH.P.K., Deçan, me Nr. Prot. 23/26/MMPH, të datës 06.01.2026.

MMPH, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni :

1. Vendimi për vazhdim të Lejes Mjedisore për operatorin "Kelkos Energy" SH.P.K., Deçan, për HC- Belaja, dhe pajimet përcjellëse: gypat, kabllot elektrik dhe fibrat optik përgjatë rrugës publike, zona kadastrale Deçan;
2. Shtojcën: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Udhëzimi Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore dhe Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 23/26/MMPH

Datë: 09.06.2026

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit si dhe nenit 17 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore i ndryshuar dhe plotësuar me Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatorit "Kelkos Energy" SH.P.K., Deçan, i vazhdohet Leja Mjedisore për HC-Belaja dhe pajisjet përcjellëse: gypat, kabllot elektrike dhe fibrat optike përgjatë rrugës publike, Zona Kadastrale Deçan,

2. Operatori obligohet:

- 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
- 2.2. T'u nënshtrohet kritereve rregulluese të Rregullore MMPH Nr. 02/2016 Për Mënyrën e Përcaktimit të Prurjes së Pranueshme Ekologjike (Korrigjuar) dhe akteve administrative ujore në proces sipas Vendimit të Ministres së MMPH Nr. prot. 2168/26, datë 27.04.2026, Për Fillimin e Zbatimit të Procedurave për Ndërprerjen e Lejes Ujore të Hidrocentraleve të Vogla.
- 2.3. Të respektohen hierarkia ujore në përputhje me Ligjin e ujërave, dhe akteve nen ligjore që rrjedhin nga ky Ligj;



- 2.4. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike, që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, po ashtu në rast të ndonjë aksidenti mjedisore të njoftoj MMPH;
- 2.5. Ti përmbahet të dhënave të përshkruara në aplikacion;
- 2.6. Për sistemin menaxhues mjedisore të ketë personin e profilit inxhinierik që është përgjegjës për mjedis; dhe
- 2.7. Pas përfundimit të veprimtarisë, operatori është i obliguar të kthej lokacionin në gjendjen e mëparshme.

Arsyetim

Pas shqyrtimit të kërkesës për vazhdim të Lejes Mjedisore me Nr. Prot. 23/26/MMPH, të datës 06.01.2026, për HC-Belaja dhe pajisjet përcjellëse: gypat, kabllo elektrikë dhe fibrat optike përgjatë rrugës publike, Zona Kadastrale Deçan, për operatorin "Kelkos Energy" SH.P.K., Deçan, vizitës në teren dhe mbajtjes së debatit publik, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore konstatoi se Operatori i plotëson kriteret e parapara në Udhëzimin Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore dhe Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Andaj, bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për vazhdimin e Lejes Mjedisore.

Ky vendim është nxjerrë, duke u bazuar edhe në dokumentacionin paraprak që ka prezantuar kompania:

- Aplikacionin e plotësuar në një kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Certifikata e regjistrimit të biznesit nga ARBK;
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, të datës 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për Leje Mjedisore;
- Pëlqimin Mjedisor me Nr. 11/445/2-ZSP-251/11, datë: 08.12.2011, për vendosjen e gypave, kabllove elektrikë dhe fibrav optik për gjatë rrugës publike përgjatë lumit Lumbardhë të Deçanit;
- Pëlqimin Mjedisor me nr. 11/445/3-ZSP-41/12, datë: 02.03.2012, për ndërtimin e Hidrocentraleve dhe gjeneruese me pajimet përcjellëse, përgjatë lumit Lumbardhë Deçan;
- Lejen Mjedisore me nr. 5837/19/MEA, datë: 06.11.2020, për HC-Belaja dhe pajisjet përcjellëse: gypat, kabllo elektrikë dhe fibrat optike përgjatë rrugës publike, Zona Kadastrale Deçan;
- Lejen Urbanistike me nr. ZSP-91/2012, datë 16.02.2012, për Ndërtimin e Hidrocentraleve Gjeneruese përgjatë lumit Lumëbardh të Deçanit;
- Kontratë nga MBPZHR, Agjensioni Pyjor i Kosovës, për shfrytëzimin e përkohshëm të tokës pyjore me nr. 4126, datë 07.10.2020;
- Marrëveshjen kontraktuese nga zyra e kryetarit të komunës së Deçanit dhe kompanisë "Kelkos Energy" SH.P.K. e protokolluar me nr. 937, datë: 16.03.2012, lidhur me



shfrytëzimin e pronës se paluajtshme të komunës se Deçanit, sipas kontratës së Servitutit për ndërtimin dhe operimin e njësive gjeneruese hidroenergjetikë "Belaja", "Deçani" dhe "Lumëbardhi II";

- Leje Përdorimi nga MMPH, për objekt ndërtimor "HC - Belaja" dhe "HC- Deçani" me nr. Prot. 3968/2019, datë 24.06.2019, me nr. të protokolluar nga ZSP; Nr. ZSP-1220/19, datë 20.09.2019;
- Vendim për certifikatë të legalizimit për ndërtimin e tubacionit, vepra e marrjes, kabllloja elektrike 35 kV dhe kabllloja nëntokësorë me fibra optik Gryka e Lumit Deçan, Komuna e Deçanit, me Nr. Reference 5704/19, të lëshuar me dt. 09.10.2020;
- Lejen ujore për HC- Belaja, për aprovimin e plotësimit të kushteve ujore, të parapara me lejet ujore paraprake me nr. prot. 4981-2/2020, të lëshuar me dt. 04.11.2020;
- Lejen Ndërtimore me nr. ZSP-321/2012, datë: 07.05.2012;
- Raportin e monitorimit për Prurjen e Pranueshme Ekologjike (PPE)- Minimumi Biologjik;
- Koordinatat e Veprave Marrëse 1 dhe 2, objektit elektrik, tubacionit, kablllos elektrike dhe FOC.

Ky vazhdim i Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, në përputhje me nenin 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 7 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore i ndryshuar dhe plotësuar me nenin 8 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Bajram Kafexholli

U.D. Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së

Vendimi i'u dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës së Deçanit;
- DMM-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit;
- Arkivit të MMPH-së.